



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

---

# Buletini informativ

- \* Aktivitetet e përgjithshme
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor si dhe stafin tjetër administrative të gjykatave dhe prokurorive
- \* Aktivitetet për trajnues

Nëntor 2023

## Aktivitetet e përgjithshme

### Punëtorja për hartimin e Programit trajnues

Me 13 dhe 14 nëntor 2023 është realizuar punëtorja për hartimin e programit trajnues për vitin 2024.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përcaktimi i Kurikulës Trajnuese për vitin 2024, në trajnimet e vazhdueshme dhe fillestare dhe hartimi i përmbajtjes në pajtim me nevojat trajnuese të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor si dhe kërkesave dhe prioritetëve tjerë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Për dy ditë me radhë kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive të ndarë në grupe punuese sipas fushave dhe në përbërje edhe të anëtarëve të Këshillit Programor kanë përcaktuar për secilën fushë çështjet ligjore që duhet të përfshihen në programin e trajnimit të vazhdueshëm dhe më pas kanë zhvilluar konceptet duke marrë për bazë edhe

metodologjinë që do të përdoret në zbatim të trajnimit përkatës.

Ngjashëm edhe në programin e trajnimit fillestar, grupi punues ka shqyrtuar përmbajtjen aktuale dhe mbi bazën e këtij programi dhe nga vlerësimi i nevojave janë bërë ndryshimet me theks te kohëzgjatja e sesioneve në disa nën module, janë shtuar module të reja dhe specifika tjera të programit për gjyqtarët e gjeneratës së radhës.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Përfaqësues nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët, Anëtarët e Këshillit Programor dhe Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, Kryetari i Komisionit për trajnime nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë nga radhët e Departamentit të Programit.

### Takimi i Këshillit Drejtues



Më 29 nëntor 2023, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit z. Vaton Durguti, Udhëheqës i Departamentit Special në Gjykatën e Apelit.

Temë kryesore e këtij takimi të Këshillit Drejtues ishte shqyrtimi dhe miratimi i

Programit Trajnues të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2024. Gjatë diskutimeve u vlerësua puna për hartimin e programit të trajnimeve, metodologjia e zbatuar gjatë procesit të hartimit, e veçanërisht përmbajtja e programit.

Gjatë takimit Këshilli Drejtues shqyrtoi dhe miratoi edhe Planin e Punës dhe Performancës për vitin 2024 si dhe miratoi propozimin për plotësim të kërkesës së Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme e parashtruar me datë 3 nëntor 2023, për zhvillimin dhe botimin e Përmbledhjes nga Praktika e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile.

Në këtë takim, Këshilli Drejtues diskutoi edhe për çështje tjera që janë në kompetencë të punës së Këshillit, lidhur me funksionimin e Akademisë së Drejtësisë.

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024

---



Gjatë muajit nëntor, për 21 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 16 sesione të trajnimit teorik dhe 13 ditë të trajnimit praktik.

Të gjitha sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi i Procedurës Penale dhe nën modulet e tij. Në kuadër të nën modulit: “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit” janë realizuar 4 sesione trajnuese nga i cili janë trajtuar: dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues, i dëmtuari, kuptimi dhe llojet e dëshmitarëve, marrja në pyetje dhe e deklaratave të dëshmitarëve para ngritjes së aktakuzës.

Nga nën moduli: “Ekspertiza dhe analiza” janë realizuar 5 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar eksperimentimet mjekoligjore, eksperti dhe pozita procedurale e tij në procedurë penale, ekspertimi dhe analizat sipas KPPRK, ekspertimi si veprim procedural në procedurë

penale, ekspertiza (Deklarata e ekspertit) si provë në procedurë penale.

Nga nën moduli: “Kontrolli dhe konfiskimi” është realizuar 1 sesion trajnues në kuadër të cilit janë trajtuar raste nga praktika vendore rreth gjykimeve nga shkalla e parë deri tek instanca më e lartë.

Në kuadër të nën modulit: “I pandehuri në procedurën penale” janë realizuar 3 sesione nga ku janë trajtuar: i pandehuri gjatë procedurës së shkurtër dhe procedura për ndihmë juridike ndërkombëtare, i pandehuri si subjekt i procedurës penale dhe deklarimi i të pandehurit si provë, të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë procedurës penale, pozita e të pandehurit pas ngritjes së aktakuzës dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe 3 sesione tjera nga nën moduli: “Procesverbalet” me ç’rast janë trajtuar krijimi dhe mbajtja e procesverbaleve, regjistrimi i seancave me incizim audio dhe me incizim audio dhe video, shikimi i procesverbalit dhe shkresave të lëndës.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

## Trajnimi për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)-2023-2024



Gjatë muajit nëntor, për gjyqtarët e kësaj gjenerate gjithsej (28 gjyqtarë, prej tyre një nga komuniteti boshnjak dhe një nga ai turk) janë realizuar gjithsej 6 sesione të trajnimit teorik dhe me këto sesione është përfunduar trajnimi teorik në Akademi. Përveç tyre janë realizuar edhe 7 vizita në institucione jo gjyqësore. Nga gjysma e muajit nëntor është filluar me zbatimin e trajnimit praktik me ç ‘rast janë realizuar edhe 12 ditë të trajnimit praktik në gjykatat ku janë të emëruar.

Në kuadër të sesioneve të trajnimit teorik janë realizuar sesionet e fundit nga moduli “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese”

përkatësisht nga nën moduli: Zhvillimi i Shkathtësive gjyqësore me ç ‘rast janë trajtuar: marrja në pyetje e drejtëpërdrejtë, marrja në pyetje e tërthorët, fjala hyrëse dhe përfundimtare dhe vënia në dyshim, po ashtu në kuadër të këtij nën moduli gjyqtarët kanë performuar secili prej tyre me video inqizime metodologjinë e shkathtësive gjyqësore. Pjesë e këtij moduli ishte edhe Simulimi gjyqësor në objektin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Institucionet të cilat janë vizituar nga gjyqtarët e sapo emëruar janë: Shërbimi sprovues, Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës, Shërbimi korrektues, Gjykata Kushtetuese, Avokati i popullit dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore. Gjyqtarët u pritën nga përfaqësuesit e institucioneve të cilët ofruan njohuri rreth fushëveprimit dhe detaje tjera të funksionimit të këtyre institucioneve.

Sa i përket sesioneve të trajnimit praktik, gjyqtarët kanë asistuar në proceset gjyqësore nën mbikëqyrjen e mentorit dhe për këtë është njoftuar në baza të rregullta Akademia.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Trajnim: Program i Specializuar i Trajnimit-Krimet e luftës, sesioni II

Më 01-02 nëntor 2023 , në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimet e Luftës – Sesiioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me legjislacionin penal në Kosovë i cili trajton veprat penale të krimeve të luftës, e po ashtu edhe legjislacionin penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe zbatimi i drejtë i tyre në praktikë për zgjidhjen meritorë të rasteve përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në gjykimin në mungesë dhe ndryshimeve legjislative në raport me gjykimin në mungesë, e cila do të shkaktojë vështirësi dhe sfida të mëdha gjatë trajtimit të rasteve të krimeve të luftës. Sipas këtyre ndryshimeve këto vepra penale të përcaktuara në nenin 104 të Kodit Penal, gjykimi në mungesë mund të mbahet edhe pa u plotësuar kriteret e parapara në këtë nen për praninë e të akuzuarit, nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar

të akuzuarin për shqyrtimin gjyqësor dhe për ta siguruar praninë e tij. Në këtë rast, i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi gjatë tërë procedurës penale, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në ditën e dytë trajnimi u përqendrua në konceptet themelore të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe përgjegjësisë komanduese sipas praktikës së TPNJ-së dhe marrjen e provave në vendin ku është e mundur. Në vijim u diskutuan edhe vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit në zbatimin e të drejtës penale ndërkombëtare në juridiksionin e Kosovës.

Gjyqtarët, prokurorët dhe pjesëmarrësit tjerë patën mundësi që të shkëmbejnë përvojat me ekspertë ndërkombëtarë në ndjekjen e krimeve të luftës sipas formave të përgjegjësisë komanduese dhe të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Këtë trajnim e vijuan 7 gjyqtarë kryesisht nga departamenti special dhe 4 prokurorë nga PRSK si dhe 11 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga departamenti special i gjykatës si dhe nga PRSK.



## Trajnim për praktikën gjyqësore për mbrojtjen gjyqësore në rastet e pengim posedimit dhe servituteve



Më 01-02 nëntor 2023, në bashkëpunim me GIZ, është realizuar trajnimi për praktikën gjyqësore për mbrojtjen gjyqësore në rastet e pengim posedimit dhe servituteve dhe e drejta pronësore me element të huaj.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore sa i përket pengim posedimit dhe servituteve për zgjidhjen e drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve përkatëse.

Trajnimi kishte për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga kjo fushë duke identifikuar rastet e gabuara nga praktika gjyqësore dhe ofrimin e zgjidhjeve adekuate praktike. Vëmendje të veçantë i është kushtuar eliminimit të dilemave gjatë vendimmarrjes duke trajtuar elementet e aktit të pengim posedimit dhe të drejtës së servitutit, afatet e mbrojtjes gjyqësore në kontestet e pengim posedimit dhe servitutit si dhe të gjitha çështjet tjera të ndërlidhura me pengim posedimin dhe servitutit.

Në këtë trajnim janë prezantuar rastet e ndryshme nga praktika e gjykatave të cilat u diskutuan me pjesëmarrësit në mënyrë interaktive, ku metodologjia u vlerësua efikase

pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në diskutime. Për mes rasteve të identifikuar të problemeve praktike dhe rasteve të ndryshme të prezantuara nga praktika e gjykatave u nxorën këto rekomandime nga ky trajnim dhe janë si në vijim:

-Të vazhdohet me mbajtje të tryezave – trajnimeve të tilla, po nga kjo fushë sepse tryeza vërtetoj nevojën dhe domosdoshmërinë e këtyre diskutimeve të hapura rreth problemeve në praktikë.

-Të merret në të ardhmen nga pjesëmarrësit problemet praktike që kanë nevojë për të shtjelluar në tryezë përkatësisht trajnim dhe të gjeturat e Gjykatës së Apelit lidhur me çështjet dhe problemet praktike të prezantuara nga pjesëmarrësit.

-Të tentohet që në tryezat tjera me qenë ndoshta grupi edhe më miks, duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave nga se edhe ata mund të jenë përfitues nga ky lloj i trajnimit.

Këtë trajnim e vijuan 57 gjyqtarë. Prej tyre 6 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 2 nga Gjykata e Apelit si dhe 49 gjyqtarë tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regionet e Kosovës.

## Trajnim: Aspekti material dhe procedural i Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij



Më 07-08 nëntor 2023, në bashkëpunim me OSBE është realizua trajnimi për gjyqtarë me temë: “Aspekti procedural dhe material i Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e këtij ligji”

Arsyeja e trajnimit ishte zgjerimi i njohurive lidhur me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe zbatimin praktik të dispozitave të këtij Ligji.

Në ditën e parë të trajnimit u elaboruan çështje nga aspekti material i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi me ç’rast vëmendje e veçantë i është kushtuar parimit të trajtimit të barabartë, organeve të thirrura në ligj për mbrojtjen nga diskriminimi, mënyrat e parashtrimit të kërkesave dhe opinionet dhe vendimet e këtyre organeve lidhur me rastet e diskriminimit.

Në ditën e dytë u elaboruan çështjet nga ana praktike në aspektin procedural si: ankesat kundër diskriminimit të Avokati i Popullit, Mbrojtja nga diskriminimi në nivelin e organeve të pushtetit lokal, Mbrojtja nga diskriminimi nga Institucionet e Nivelit Qendror, paditë dhe mosmarrëveshjet për diskriminimin etj.

Në këtë trajnim janë prezantuar rastet e ndryshme nga praktika e gjykatave dhe lidhur me këto raste u diskutua me pjesëmarrësit në mënyrë interaktive, ku metodologjia u vlerësua efikase pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në diskutime.

Të gjithë pa përjashtim konfirmuan nevojën për vetëdijesimin e qytetarëve për t’iu çasur organeve kompetente për trajtimin e

diskriminimit. Ky vetëdijesim duhet të filloj që në familje, pastaj në shkolla, tek këshillat e prindërve, OJQ dhe organet publike. Po ashtu u tha që Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe ligjet tjera në fuqi, ofrojnë mbrojtje afirmative të të drejtave të njeriut, posaçërisht mbrojtja nga diskriminimi megjithatë ky ligj nga ana e organeve ligj zbatuese shoqërohet me sfida të shumta në zbatimin e tij. Prandaj edhe kërkohet pos tjerash:

- Organizimi i tryezave dhe diskutimeve lidhur me nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi;
- Bashkëpunimi rreth zbatimit të politikave për mbrojtje nga diskriminimi;
- Prioriteti i shqyrtimit të lëndëve që lidhen me diskriminimin;
- Vendimet e GJEDNJ të shërbejnë si shembull për vendimet e gjykatave vendore lidhur me diskriminimin, në mënyrën siç është përcaktuar me nenin 24 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në Republikën e Kosovës
- Nevoja e ngritjes profesionale dhe organizimit të trajnimeve nga ana e Akademisë së Drejtësisë në ngritjen profesionale të gjykatësve në trajtimin praktik dhe vendosjen lidhur me rastet që lidhen me diskriminimin;
- Nevoja e ngritjes profesionale dhe organizimit të trajnimeve nga ana e Odës së Avokatëve të Kosovës për pjesën e avokatisë që të ushtrojnë padi dhe përfaqësojnë palët në mënyrën më të mirë para gjykatave, në rastet e diskriminimit;
- Nevoja e nxjerrjes së një Mendimi Juridik nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me lartësitë e kuotave të shpërblimit të dëmit në rastet e diskriminimit, etj.

Këtë trajnim e vijuan 12 gjyqtarë. Prej tyre 4 nga Gjykata e Apelit dhe 8 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Trajnim: Trafikimi me pasuritë kulturore-biznes kriminal fitim prurës

Më 07 nëntor 2023, , Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën e Francës në Kosovë dhe Muzeun Kombëtar në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme kanë realizuar Seminarin me temë “Trafikimi i aseteve të trashëgimisë kulturore: një aktivitet kriminal fitimprurës”.

Fjalimet hyrëse në këtë seminar ishin nga Shkelqesia e TIJ. ambasadori i Francës në Kosovë, Z. Olivier Guerot , Zëvendësministri i Drejtësisë së Kosovës, Z. Vigan Qorrolli, Drejtoresha e Muzeut Kombëtar të Kosovës, Znj. Vjollca Aliu si dhe Drejtori i Akademisë së Drejtësisë, Z. Enver Fejzullahu.

Qëllimi i seminarit ishte shkëmbimi i praktikave profesionale mes profesionistëve të Francës dhe të Kosovës (Ministritë së kulturës, zyrtarëve policor, zyrtarëve të doganave, gjyqtarëve dhe prokurorëve, etj) në trajtimin e rasteve të trafikimit të aseteve dhe trashëgimisë kulturore.

Trajnues të angazhuar në këtë seminar ishin: Pascal Brunet, drejtor i platformës Relais Culture Europe, .Thomas LECLAIRE, kapiten policor, shef i grupit të inteligjencës kriminale në Zyrën Qendrore për Luftën kundër

Trafikimit të Aseteve të Trashëgimisë Kulturore (OCBC), Eric Serfass, zv/prokuror në Gjykatën gjyqësore të Parisit, juridiksionit kombëtar i luftës kundër krimit të organizuar (JUNALCO); Agron Qalaj, prokuror në zyrën e Kryeprokurorit të Kosovës.

Gjatë këtij seminari u diskutua për Strategjinë Evropiane, programet, mbështetja për hulumtimet në fushën e trafikimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, metodat e veprimit, asetet e trashëgimisë kulturore të targetuar, rrugët e trafikimit si dhe për inteligjencën dhe mjetet e hetimit në Francë dhe në Kosovë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar reagimit gjyqësor francez dhe kosovar ndaj trafikimit të aseteve të trashëgimisë kulturore me theks të dënimit dhe dorëzimi i aseteve.

Metodologjia e seminarit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij seminari ishin: 3 gjyqtar, 5 prokuror 1 zyrtarë administrativ nga gjykata, 5 zyrtarë policor dhe 5 zyrtarë të doganave si dhe mbi 20 zyrtar nga Ministria e kulturës.





## Trajnim: Ndërmjetësimi-(Prizren-Gjakovë)

Më 09 nëntor 2023 në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e “USAID – Drejtësia Komerciale”, është realizuar trajnimi me temë “Ndërmjetësimi” për regjionin e Pririt dhe Gjakovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndërmjetësuesve lidhur me metodën alternative për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet dy apo më shumë personave dhe zbatimin e drejtë të ndërmjetësimit dhe procedurës në praktikë.

Trajnimi ka filluar direkt me shtjellimin nga ana e trajnuesit për gjendjen aktuale të ndërmjetësimit dhe shkaktarët që e kanë sjell në këtë gjendje ku janë renditur në tri grupe: keqkuptimi, keqinterpretimi dhe keqpërdorimi, duke vazhduar me dhënien e sqarimeve për secilin grup.

Në trajnim fokus i veçantë ka qenë roli i gjyqtarit dhe ndërmjetësuesit në procedurën e ndërmjetësimit, pasi që në praktikë nuk është duke u vepruar konform rolit dhe përgjegjësisë nga këta dy akterë kryesor.

Po ashtu është diskutuar edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore. Vëmendje të veçantë iu kushtua zbatimit të procedurës tek ndërmjetësimi i detyrueshëm, ekzaminimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit dhe hapat që pasojnë duke përfshirë edhe debat profesional, shoqëruar me praktike, dhe me udhëzime të qarta dhe bindëse pothuajse për secilin problem, sfidë apo dilemë të ngritur.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Këtë trajnim e vijuan 35 pjesëmarrës, prej tyre 13 gjyqtarë, 3 prokurorë, 7 ndërmjetësues 1 zyrtarë nga shërbimi sprovues si dhe 4 staf administrative nga gjykatat dhe prokuroritë e këtyre regjioneve.



## Personat juridik si kryes të kundërvajtjes

Më 09 Nëntor 2023, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është realizuar trajnimin me temë “Personat juridik si kryes të kundërvajtjes”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve të divizionit të kundërvajtjes lidhur me mënyrën e zhvillimit të procedurës për kundërvajtje ndaj subjektit afarist që e ka cilësinë e personit juridik dhe ndaj personit përgjegjës të personit juridik.

Trajnimi në fillim u përqendrua në procedurën e kundërvajtjes ndaj personave juridik si kryes të kundërvajtjes dhe në vijim edhe me shpjegime të hollësishme sa i përket përgjegjësisë së personit juridik dhe përgjegjësisë së personit përgjegjës të personit juridikë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe rasteve kur subjektet afariste si biznese individuale janë kryes të kundërvajtjes dhe zhvillimi i proce-

durës ligjore ndaj tyre duke përfshirë edhe përgjegjësitë e personit fizik.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin e studimit të rasteve praktike për të cilat ofruan perspektivën e tyre bazat e përgjegjësisë së kundërvajtjes së personave juridik dhe situata tjera kur në procedurë konstatohet se personi përgjegjës nuk mbanë përgjegjësi për kundërvajtje.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 14 gjyqtarë nga Divizioni i Kundërvajtjes nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Tryezë për drejtësinë ambientale

Më 10-11 nëntor 2023 në bashkëpunim me UNDP, është realizuar tryeza për drejtësinë ambientale.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me ndarjen e përvojave praktike dhe krahasimin midis gjyqtarëve dhe prokurorëve në hetime dhe gjykime penale të ndërthurura me mjedisin.

Në këtë tryezë u diskutua për Sfidat nga praktika gjyqësore në gjykimin e rasteve që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit, Hetimi dhe akuzimi i kryerësve të veprave penale që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit, Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastet e mbrojtjes së mjedisit, Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas KPRK, Aspekte të mbrojtjes së mjedisit.

Në tryezë u theksuan cilat janë veprat penale kundër ndotjes dhe degradimit të mjedisit si dhe u identifikuan elementet të cilat formojnë figurat e veprave penale kundër mjedisit, natyrës dhe pyllit.

Gjatë tryezës është analizuar ligji në Kosovë dhe praktikat aktuale të hetimeve penale të mjedisit, e që më tutje janë diskutuar disa raste studimi nga praktika e gjykatave vendore lidhur me situata te caktuara e për te cilat lidhen me

situatat te cilat paraqiten ne Gjykate.

Metodologjia e kësaj tryeze ishte biseda interaktive, shembuj nga praktika gjyqësore, raste hipotetik, pyetje përgjigje dhe eliminimi e shkeljeve të veprave në këtë fushë dhe paraqitja e materialit përmes PowerPoint.

Gjatë tryezës përfaqësuesi i UNDP-së i njoftoi pjesëmarrësit se në kuadër të kësaj tryeze do të përgatitet një manual që do të përfshijë hollësitë e veprave penale të mjedisit, aspektet materiale dhe procedurale, udhëzime për hetime efektive dhe vendimmarrje cilësore, ku përveç kësaj, manuali do të përmbajë një skemë të pikave kyçe të kontrollit lidhur me elementet e veprave penale dhe provave, si dhe kontrollin e akteve akuzuese. Udhëzuesi mund të përfshijë edhe aspekte të drejtësisë ambientale në kontekstin administrativ dhe të çështjeve Kundërvajtëse.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan debatin me një përshtypje të përgjithshme se tryeza ishte e dobishme, pasi të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në bisedë. Në fund trajnuesit falënderuan pjesëmarrësit për angazhim konstruktiv që patën gjatë këtyre dy ditëve, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për realizimin e kësaj tryeze dhe bashkëpunimin e ndërsjellët që ka me UNDP.

Në këtë tryezë morën pjesë 24 pjesëmarrës, ku 5 prej tyre ishin gjyqtarë, 5 prokurorë dhe 14 bashkëpunëtor profesional.



## Trajnim: Procedura dhe zbatimi i Ligjit për regjistrimin civil në Kosovë

Më 14 nëntor 2023, është realizuar trajnimi trajnimi për gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional me temë: “Procedura dhe zbatimi i Ligjit për regjistrimin civil në Kosovë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive lidhur me trajtimin e koncepteve themelore të Ligjit për regjistrimin civil të Kosovës si dhe zbatimit të tij në praktikën gjyqësore.

Ky trajnim ishte i dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizojë dhe zbërthejë procedurën e cila zhvillohet për ndryshimin dhe korrigjimin e emrit personal, regjistrimin e lindjeve, martesave dhe vdekjeve si dhe institucionet kompetente. Gjatë këtij trajnimi janë identifikuar disa raste të cilat janë prezantuar nga praktika gjyqësore vendore

Në vijim është diskutuar çështja e kompetencës lidhur me çështjet juridike për ndryshimin e të dhënave të përbërësve e të dhënave të gjendjes civile, dhe është sqaruar se kompetent është

Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë e për të cilën paraprakisht duhet të udhëhiqet procedurë administrative pranë Agjencionit për Regjistrim Civil ARC.

Më tutje janë diskutuar disa raste studimi nga praktika e gjykatave vendore dhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut të cilat u elaboruan me veçantitë dhe specifikat e tyre.

Gjatë trajnimit u tha që regjistrimi civil është kusht për parandalimin e pa - shtetësisë dhe i cili ndërlidhet me qasjen në të drejta tjera. Regjistrimi civil trajtohet në këndvështrimin e të drejtave themelore bazë të njeriut duke pa regjistrimin civil si pikënisje për zbatimin e të gjithë të drejtave të tjera të njohura prej instrumenteve ndërkombëtare dhe ato të brendshme të një shteti.

Në këtë trajnim morën pjesë 7 pjesëmarrës Prej tyre 6 gjyqtarë dhe 1 bashkëpunëtor profesional.



## Program i Specializuar i Trajnimit-Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi-Sesioni III

Më 14-15 nëntor 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi – Sesioni III”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Kornizen strategjike dhe institucionale të bashkëpunimit në çështjet kundër terrorizmit, përballja me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që favorizojnë terrorizmin për zgjidhjen e drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve përkaëse.

Gjatë trajnimit u potencua që Strategjia kundër terrorizmit si dhe masat tjera legjislative dhe politike në kuadër të kësaj fushe, janë të ndërlidhura me prioritet strategjike për “Qeverisja të Mirë dhe Sundimit të Ligjit.” Për shkak të pranisë së elementëve të ekstremizmit dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm, janë hartuar një mori instrumentesh të rëndësishme ligjore, ku fokus ka qenë lufta efikase ndaj këtyre dukurive të kundërligjshme, gjithnjë nga perspektiva e instrumenteve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht ndjekjes dhe gjyqimit.

Po ashtu u vu në pah edhe nxitja e terrorizmit dhe rekrutimi për çështje terrorizmi e cila duhet të penalizohet dhe ndiqet sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Çdo inkriminim duhet të përcaktohet me saktësi në ligj dhe nuk duhet të ketë si objektiv një grup apo individ të caktuar. Fakti që dikush ka pikëpamje apo mendime, të cilat konsiderohen si radikale apo ekstreme, si edhe shprehja e lirë e tyre nuk duhet të kriminalizohen. Parandalimi i terrorizmit me kalimin e kohës kërkon që kushtet që favorizojnë terrorizmin të trajtohen siç duhet dhe pa i dhënë ngjyrimë të panevojshme të natyrës së sigurisë.

Pjesëmarrësit patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat mundësuan diskutime interaktive dhe perspektiva të zgjidhjes ligjore për situatat konkrete.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjithësejt 9 pjesëmarrës. Prej tyre: 2 gjyqtarë dhe 1 prokurorë nga niveli Themelor, 3 zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës dhe 3 zyrtar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.



## Trajnim: Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve



Më 15 nëntor 2023, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, projekti PRO-FREX, është realizuar trajnimi për gjyqtarë dhe prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor me temë: “Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve”. .

Trajnimi kishte qëllim të rrisë kapacitetet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e sigurisë së gazetarëve dhe mbrojtjen e tyre gjyqësore duke marrë shembull standardet e njohura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastet vendore.

U diskutua për heshtjen e gazetarëve rreth burimeve të tyre të informacionit, që nënkupton të drejtën për të mbrojtur identitetin e burimeve të informacionit përpara gjykatës gjatë procedurës penale.

Gjatë këtij aktiviteti, ekspertët ndanë njohuri të

vlefshme rreth standardeve dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe detyrimet e shteteve për të mbrojtur gazetarët. Një diskutim i thellë u zhvillua mbi sfidat unike me të cilat përballen gazetarët vendas, duke përfshirë sulmet fizike, kërcënimet dhe barrierat ligjore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar detyrimit që shtetet kanë për të krijuar një kuadër të shëndoshë ligjor për gazetarët dhe akterët e tjerë të medias që të punojnë të sigurt. Praktika gjyqësore e Gjykatës vendos pika referimi të rëndësishme në lidhje me hetimin efektiv të sulmeve ndaj gazetarëve, mbrojtjen e burimeve gazetareske, të drejtën e mbledhjes së lajmeve dhe tema të tjera përkatëse.

Në këtë trajnim janë prezantuar rastet e ndryshme nga praktika e gjykatave dhe lidhur me këto raste u diskutua me pjesëmarrësit në mënyrë interaktive, ku metodologjia u vlerësua efikase pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në diskutime.

Këtë trajnim e vijuan 15 pjesëmarrës. Prej tyre 2 gjyqtarë, 1 prokuror, 8 bashkëpunëtorë profesional dhe 4 hetues nga Policia e Kosovës



## Tranim: Ndërmjetësimi - (Pejë)

Më 16 nëntor 2023, kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e “USAID – Drejtësia Komerciale”, është realizuar trajnimi me temë “Ndërmjetësimi” për regjionin e Pejës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndërmjetësuesve lidhur me metodën alternative për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet dy apo më shumë personave dhe zbatimin e drejtë të ndërmjetësimit dhe procedurës në praktikë.

Trajnimi ka filluar direkt me shtjellimin nga ana e trajnuesit për gjendjen aktuale të ndërmjetësimit dhe shkaktarët që e kanë sjell në këtë gjendje ku janë renditur në tri grupe: keqkuptimi, keqinterpretimi dhe keqpërdorimi, duke vazhduar me dhënien e sqarimeve për secilin grup.

Në trajnim fokus i veçantë ka qenë roli i gjyqtarit dhe ndërmjetësuesit në procedurën e ndërmjetësimit, pasi që në praktikë nuk është duke u vepruar konform rolit dhe përgjegjësisë nga këta dy akterë kryesor.

Po ashtu është diskutuar edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore. Vëmendje të veçantë iu kushtua zbatimit të procedurës tek ndërmjetësimi i detyrueshëm, ekzaminimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit dhe hapat që pasojnë duke përfshirë edhe debat profesional, shoqëruar me praktike, dhe me udhëzime të qarta dhe bindëse pothuajse për secilin problem, sfidë apo dilemë të ngritur.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjithësejt 21 pjesëmarrës. Prej tyre 11 gjyqtarë dhe 1 prokurorë, 3 bashkëpunëtorë profesional nga gjykatat dhe prokuroritë si dhe 5 ndërmjetësues dhe 1 Udhëheqës i Qendrës Regjionale të SHSK-së .



## Trajnim: Marrja në pyetje e viktimës së mitur

Më 21 Nëntor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Marrja në pyetje e viktimës së mitur”.

Trajnues i angazhuar në këtë trajnim është: z. Kujtim Munishi, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur lidhur me intervistimin e viktimës së mitur me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale dhe zbatimi i drejtë në praktikë.

Trajnimi në fillim u përqendrua në risitë ligjore sa i përket intervistimit të viktimës së mitur në prokurori dhe për mundësinë hetuese të

veçantë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar parimeve themelore që duhet pasur në konsideratë duke përfshirë edhe specifikat tjera gjatë procedimeve penale.

Në vijim u diskutua edhe për palët procedurale dhe sfidat në praktikë si dhe për teknikat dhe taktikat e marrjes në pyetje të viktimave të mitura.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 9 gjyqtar 2 dhe prokuror nga Departamenti për të Mitur dhe Departamenti i Përgjithshëm..





## Trajnim: Pasurimi pa bazë

Më 21 nëntor 2023, është realizuar trajnimi për gjyqtarët me temën: “Pasurimi i pa bazë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me institutin e pasurimit pa bazë dhe vendosjen në këto raste.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështje me rëndësi nga pasurimi i subjektit, varfërimi i subjektit tjetër si dhe lidhja kauzale ndërmjet pasurimit dhe varfërimit.

Në pjesën e dytë trajnimi u përqendrua në çështjet si pagimi pa pasur borxh, pagimi duke pasur parasysh bazën që nuk është realizuar, pagimi sipas bazës që më vonë ka dështuar, pasurimi pa bazë me veprimin e subjektit të pasuruar, pasurimi pa bazë me veprimin e personit të tretë ose nga efekti i fuqisë madhore si dhe për afati për paraqitjen e padisë. U tha se me padi për pasurim pa bazë mund të kërkohet vetëm kthimi i asaj pasurie e cila i është marrë të varfëruarit, mirëpo i varfëruari mund të shfrytëzoj edhe padinë për dëmshpërblim, sepse në këto raste më së shpeshti është në pyetje veprimi i palejueshëm i personit të pasuruar, pra mund të realizoj i varfëruari fitimin e humbur.

Gjatë diskutimeve janë eliminuar disa probleme praktike që i referohen procedurës që duhet zhvilluar gjykata në rastet e pasurimit pa bazë, format e pasurimit pa bazë, mjetet provuese te

këto raste, dallimi me format tjera të marrëdhënieve të detyrimeve, e posaçërisht me gjerimin e punëve të huaja pa porosi.

Në këtë trajnim janë prezantuar rastet e ndryshme nga praktika e gjykatave dhe lidhur me këto raste u diskutua me pjesëmarrësit në mënyrë interaktive, ku metodologjia u vlerësua efikase pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në diskutime duke dhënë një kontribut të madh me komentet dhe diskutimet e tyre.

Gjatë këtij trajnimi nga diskutimet e trajnuesve me pjesëmarrës si rekomandime të rëndësishme kanë rezultuar si në vijim:

Të organizohen tryeza në të cilat do të trajtohet vetëm aspekti i dilemave praktike që do ti shërbente unifikimit të praktikës juridike me rastin e vendosjes lidhur me këto raste,

Për hir të unifikimit dhe ekonomizimit të procedurës propozohet që tema të tilla të trajtohen dhe të ketë takime në mes të gjyqtarëve të të gjitha instancave gjyqësore, me qëllim të heqjes së dilemave praktike lidhur me këto procedura.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 29 gjyqtarë nga të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.



## **Trajnim: E drejta për një proces të rregullt gjyqësor-KEDNJ dhe praktika gjyqësore-Aspekti penalo juridik**

Më 22 Nëntor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me OSBE është realizuar trajnimi me temë “E drejta për një proces të rregullt gjyqësor-KEDNJ dhe praktika gjyqësore-Aspekti penalo juridik”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve për dispozitën e nenit 6 të KEDNJ-së përkatësisht mbi të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe respektimin e saj në procedurën penale.

Trajnimi u përqendrua në interpretimin e nenit 6 të KEDNJ-së, përkatësisht për të drejtën në gjykim të drejtë në procedurat penale me theks te kuadri i të drejtës në gjykim të drejtë dhe parimet konventore, barazinë e palëve në procedurë, kohëzgjatja e procedurës penale, e drejta në mbrojtje, prezumimi i pafajësisë duke

përfshirë edhe parimin NE BIS IIN IDEM dhe përjashtimet nga ky parim.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar praktikës së GJEDNJ-së në aspekt të shkeljeve të KEDNJ kundër shteteve nacionale përkatësisht trajtimi i rasteve në të cilat GJEDNJ ka verifikuar shkelje të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në rastet penale.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 24 pjesëmarrës. Prej tyre 20 gjyqtarë dhe 4 prokurorë.



## Tryezë: Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave, ankesave në lëminë penale

Më 23 Nëntor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëminë penale”.

Qëllimi i këtij i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe lidhur me marrëdhëniet midis Gjykatës Kushtetuese dhe atyre të rregullta, dhe veçanërisht marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese dhe atyre të larta.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua për procedurën e lejueshmërisë së kërkesave të natyrës penalo juridike. Vëmendje e veçantë i është kushtuar raportit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me Gjykatën Supreme dhe gjykatat e rregullta në

Republikën e Kosovës si dhe mbi rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

U trajtuan edhe çështjet nga praktika gjyqësore aktuale e kësaj gjykate sipas kërkesave - ankesave në lëminë penale që në të shumtën e rasteve ishin për kohën e mbajtjes në paraburgim të personave të dyshuar për vepra penale, tejkallim të afatit ligjor për mbajtje në paraburgim, vazhdimin e paraburgimit nga gjykatat e rregullta dhe arsyetimin e vendimit për vazhdimin e paraburgimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 15 pjesëmarrës. Prej tyre 13 gjyqtarë ( 3 nga Apeli dhe 10 nga Gjykatat Themelore) si dhe 2 prokurorë nga niveli Themelor.



## Trajnim: Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve

Më 27, 29, 30 nëntor si dhe 01 dhe 4 dhjetor 2023, në bashkëpunim me UNDP/SAEK në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi 5 ditor lidhur me hetimet dhe rikuperimin e aseteve. Ky trajnim është realizuar në formë hibride me pjesëmarrje fizike ndërkaq është shfrytëzuar platforma e mësimin në distancë MOODLE në kuadër të cilës pjesëmarrësit kanë pasur qasje në materialet ligjore, testet dhe rastet praktike që janë përdorur gjatë trajnimit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive lidhur me hetimin financiar dhe kthimin e aseteve, sa i përket hetimit të veprave penale të Korrupsionit nga kapitulli 33 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Shpëlarjes së parave dhe Kthimin e aseteve të fituara me vepër penale për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.

Për pesë ditë me radhë trajnimi u fokusua në ofrimin e shpjegimeve për mënyrën e gjurmimit të aseteve dhe organizmit të provave elektronike. Pastaj u diskutua për elementet e krimit bazuar në legjislacionin në fuqi, si behet qasja ne

hetime financiare. Vëmendje e veçantë iu kushtua metodës interaktive për vërtetimin e të hyrave ilegale. Gjithashtu u trajtua ndihma e ndërsjellë juridike dhe cilët janë mekanizmat për konfiskim të aseteve.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të aplikojnë drejtpërdrejtë përmes Platformës së mësimin në distancë të Akademisë së Drejtësisë, teknikat sa i përket hetimit të veprave penale të Korrupsionit nga kapitulli 33 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Shpëlarjes së parave dhe Kthimin e aseteve të fituara me vepër penale.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan trajnimin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm.

Në fund, trajnuesit falënderuan pjesëmarrësit dhe angazhim konstruktiv, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për organizmin e trajnimit. Këtë trajnim e vijuan 16 pjesëmarrës. Prej tyre 4 prokuror, 6 bashkëpunëtorë profesional, 1 zyrtar ligjor 4 zyrtarë policor dhe 1 zyrtar nga ATK.



## Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

### Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural- Grupi VII



Më 01-03 nëntor 2023, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar sesionet e trajnimit për bashkëpunëtorë profesional. Kësaj radhe për grupin e VII -të nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor me temë “Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritorë të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale u diskutua për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si dhe Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se.

Në kuadër të këtyre trajnimeve u diskutua për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësisë

së vogël dhe përgjegjësia penale. Në kuadër të pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Në veçanti u trajtuan Politikat ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, përvetësimi dhe mashtrimi ne detyre, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtar. Gjithashtu u elaboruan rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit te rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik te rrethanave për ta peshuar me rastin e matjes se dënimit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

01 nëntor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 30 pjesëmarrës, prej tyre ishin 15 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.

02 nëntor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 13 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.

03 nëntor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 14 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.

## Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural Grupi VII-të

Më 13-15 nëntor 2023, për grupin e VII-të të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor janë vazhduar 3 sesionet e radhës nga Moduli bazik në fushën penale. Këto sesione ishin për aspektin procedural me theks te “Fazat e procedurës penale, Mjetet Juridike dhe procedurat e veçanta si dhe Aktakuza - shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive për procedurën penale dhe zbatimin e saj drejtë në praktikën gjyqësore.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese u diskutua për parimet, kompetencën dhe palët në procedurën penale, Veprimet parapenale dhe fazat e procedurës penale, Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit në procedurën penale, Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi.

Gjatë këtyre trajnimeve u trajtuan: Kallëzimi penal, procedura paraprake, Aktvendimi për hushje të kallëzimit penal, aktvendimi për fillimin e hetimeve, Aktvendimi për zgjerimi të hetimeve si dhe Aktvendimi për pushim të

hetimeve. Në vazhdim u trajtuan Mjetet juridike, administrimi i procedurës, procedura për dhënien e urdhërit ndëshkues si procedurë e veçantë si dhe procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca. Në veçanti u trajtua Shqyrtimi gjyqësor dhe aktgjykimi.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore, përmes pune s ne grupe te hartojnë vendimet gjyqësore, të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

13 nëntor 2023, Përfitues në trajnim ishin 15 pjesëmarrës. prej tyre 9 ishin bashkëpunëtorë profesional, 6 zyrtar ligjor nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.

14 nëntor 2023, Përfitues në trajnim ishin 18 pjesëmarrës, prej tyre 11 bashkëpunëtorë profesional, dhe 7 zyrtar ligjor nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.

15 nëntor 2023, Përfitues në trajnimin ishin 17 pjesëmarrës prej tyre 10 bashkëpunëtorë profesional, 7 zyrtar ligjor nga Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.



## Trajnim për protokoll

Me 16-17 nëntor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për stafin administrativ të gjykatave është realizuar trajnimi për protokollin.

Qëllimi i trajnimit ishte që stafi administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive të avancojnë njohuritë e tyre rreth rregullave dhe praktikave më të mira sa i përket protokollit.

Në këtë trajnim fillimisht u diskutua për pritjen e delegacioneve, protokollin me rastin e pritjes së delegacioneve, korrespondenca diplomatike, si dhe natyra e ndryshimit të diplomacisë duke elaboruar praktikën më të mira vendore krahasuar me ato ndërkombëtare të cilat ndihmon zyrtarët e institucioneve të zotërojnë bazat e mirësjelljes dhe të kuptojnë më mirë sjelljet multikulturale.

Gjatë këtij trajnimi u theksua që Protokollin dhe Etiketa diplomatike përfshin rregulla të mirësjelljes në shkallë lokale dhe ndërkombëtare. Me theks të veçantë u trajtuan aspekti ceremonial i procedurave të protokollit dhe rregullat e mirësjelljes në shoqëri. Gjithashtu në mënyrë praktike nga trajnuesi u elaborua si behet, prezantimi i vetes dhe

organizatës apo institucionit ku shërbeni, përgatitja e ftesave për ngjarje të ndryshme dhe nivele të ndryshme formaliteti, planifikimi dhe përgatitja për organizimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe takimin e personaliteteve.

Në veçanti u trajtuan Etiketa e punës e cila ka të bëjë me ndërtimin e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë dhe jo me rregulla dhe rregullore. Ajo lidhet me sigurimin e komoditetit bazë shoqëror dhe krijimin e një mjedisi nëpërmjet komunikimit efektiv dhe të përmirësuar. Etiketa është një term kolektiv për një grup normash dhe konventash që rregullojnë sjelljen shoqërore dhe kërkohet në marrëdhëniet shoqërore.

Në këtë trajnim u përdoren metoda të kombinuara trajnuese, shpjegime teorike, diskutime interaktive, prezantime në PowerPoint, studime të rasteve praktike, si dhe simulime të ndryshme.

Përfitues të trajnimit ishin 20 zyrtarë administrativ të gjykatave dhe prokurorive nga të gjitha Regjionet e Kosovës.



## Aktivitetet për profesionet e lira

### Trajnim i avancuar për parandalimin e Dhunës në Familje - Konventa e Stambollit

Më 24 nëntor 2024, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Organizatën Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal – CLARD dhe IKD, në mbështetje të Ambasadës Amerikane në Prishtinë Departamentit të Shtetit Amerikan Byrosë së Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit INL kanë realizuar trajnimin me temë “Trajnim i avancuar për parandalimin e Dhunës në Familje - Konventa e Stambollit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Konventën e Stambollit si mjet i rëndësishëm për luftimin e sfidave dhe zbatimin e praktikave të mira.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua: Konventa e

Stambollit dhe Këshilli i Evropës, Principet e Konventës si dhe Fakt mbledhja për Shtetin përkatës nga Këshilli i Evropës. Me theks të veçantë u diskutuan sfidat e avokatëve për përfaqësimin e rasteve në GJEDNJ.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive, me ç’rast nga trajnuesi u elaboruan raste të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 9 avokatë nga gjitha regjionet e Kosovës si dhe 2 zyrtar për ndihme juridike falas.





## Aktivitetet për trajnues

### Trajnimi i trajnuesve për metodologjinë HELP

Më 15-16 nëntor 2023 në bashkëpunim me Këshillin e Evropës është realizuar Trajnimi i Trajnuesve lidhur me Metodologjinë e Arsimit të Profesionistëve Ligjor për të Drejtat e Njeriut (HELP) me synim të përgatitjes së trajnuesve të ardhshëm të kurseve të mësimit në distancë (e-learning) të postuara në platformën online të Këshillit të Evropës.

Qëllimi i Trajnimit të Trajnuesve lidhur me HELP, është përgatitja e pjesëmarrësve në përmbushjen e rolit të trajnuesve të HELP-it, si dhe që ti pajisin ata me shkathtësitë e nevojshme, në mënyrë që të jenë trajnues të suksesshëm të kurseve online të HELP-it, sipas konteksteve të tyre përkatëse. Ky trajnim fokusohet në metodologjinë e HELP-it për profesionistët ligjor dhe në platformën e mësimit në distancë të HELP-it.

Sesionet e Trajnimit të Trajnuesve për HELP janë një ndër instrumentet mbështetëse të institucioneve vendore të trajnimit gjyqësor, siç është Akademia e Drejtësisë, Odat e Avokatëve dhe akterëve tjerë në ofrimin e trajnimeve të cilësisë së lartë për profesionistët ligjor. Kurset online të HELP-it në fillim dizajnohen si kurse

model në gjuhën angleze dhe mandej përkthehen dhe adaptohen me rendin ligjor dhe praktikat vendore.



Për dy ditë me radhë u diskutua për programin HELP dhe misionin e tij, rolin që ata si trajnues do të kenë në zbatimin e kurseve të HELP-it, adaptimin e kurseve me rendin vendor juridik si dhe me nevojat e audiencës së fokusuar, për nevojën e ofrimit të këtyre kurseve nga të trajnuarit, përdorimin e platformës dhe moderimin e kurseve.

I gjithë trajnimi është moderuar dhe udhëhequr nga dy ekspertet e Këshillit të Evropës: znj. Giulia Lo-Presti, koordinatore e Projektit të BE-KE “Trajnimi Gjyqësor për Sundimin e Ligjit dhe të Drejtat Themelore”, Divizioni i HELP, Këshilli i Evropës dhe znj. Jasminka Peruničić - Allen, Zyrtare e Lartë e Projektit/ HELP –i në Ballkanin Perëndimor, Këshilli i Evropës.


Përfitues të trajnimit ishin 9 gjyqtarë, 4 prokurorë, 4 avokat , 1 përmbarues privat si dhe 1 Zyrtare e lartë për mundësi të barabarta dhe mbrojtje nga diskriminimi





## Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve





## Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve






## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660